

VENDIM
Nr.416, datë 2.7.2004

**PËR PËRCAKTIMIN E MADHËSISË SË PAKETËS SË AKSIONEVE TË KAPITALIT TË
SHOQËRISË ANONIME “ALBTELECOM”, QË U OFROHET INVESTITORËVE
STRATEGJIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të neneve 1 e 2 pika 1 të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom””, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përqindja e aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime “Albtelecom”, që u ofrohet investitorëve strategjikë, të jetë 76 për qind, për të nxitur investimet e shoqërive të specializuara në sistemin kombëtar të telekomunikacionit. Investitori strategjik ka të drejtë të marrë pjesë në transferimin e paketës së mbetur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Pjesë e paketës së shitjes së shoqërisë anonime “Albtelecom” të jetë edhe shoqëria e re, që ofron shërbimin publik telefonik të lëvizshëm, tokësor, “Eagle Mobile”.

3. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano